

SHARING STORIES. SHAPING THE FUTURE: DIALOGUES FOR SPACE

REPORT FOR WORKSHOP II

30 OCTOBER - 1 NOVEMBER 2014

SHKËMBEJME PËRVOJAT, FORMËSOJME TË ARDHMEN: DIALOGJET PËR SPAÇIN

RAPORT I PUNËTORISË II

30 TETOR - 1 NËNTOR 2014

CONTENTS

PERMBAJTJE

Executive summary	3	Përmbledhje ekzekutive
Introduction	5	Hyrje
Workshop agenda	8	Axhenda e realizuar
List of participants	10	Lista e pjesëmarrëve
Working process	12	Procesi i punës
Values analysis	12	Analiza e vlerave
Keywords and vision statements	15	Fjalët kyçe dhe deklaratat e vizionit
Operational framework of museums in Albania	19	Kuadri operacional i muzeve në Shqipëri
Current of situation of Spaç by the Min. of Culture	20	Aktualiteti në lidhje me Spaçin nga Min. e Kulturës
Experiences from abroad	21	Përvojat nga jashtë
Objectives analysis	28	Analiza e objektivave
Visits around Shkodra	30	Vizita në Shkodër
Evaluation of the workshop	32	Vlerësimi i punëtorisë
Further information	38	Informacione të mëtejshme

EXECUTIVE SUMMARY

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

While there should exist a consensus among institutions, citizens and civil society that Spaç can and should be a place to document and confront the macabre abuses of the Communist period, very little has been said until today about the way that Spaç can be turned into a contemporary museum.

A careful and realistic approach is needed in order to turn this former prison into a museum. The formulation of this approach is the goal of the project “Sharing Stories, Shaping the Future: Dialogues for Spaç,” currently being implemented by Cultural Heritage without Borders (CHwB) with support from the International Coalition of Sites of Conscience.

The second workshop in this process employed an inclusive methodology and a wide range of actors to highlight the primary values of Spaç, using these values as the basis for formulating a joint vision statement for the future of the site. In addition, examples of similar sites from around the country and abroad were also considered, as possible approaches to creating a museum. One of the primary results from Workshop II was the formulation of clear, operational objectives for Spaç, which will guide the creation of an action plan—giving life to the identified priorities. This action plan will be developed during Workshop III.

The objectives formulated during Workshop II are:

1. *Education, interpretation and public engagement*

- a. Raise awareness and educate the national and international community about the history of suffering and resistance of the former prisoners at Spaç.
- b. Interpret the site so that each individual understands the value of Spaç and contributes to its preservation and promotion.
- c. Cooperate widely to achieve inclusion and integration of former prisoners and marginalized groups

Ndërsa duket të ekzistojë një konsensus mes institucioneve, qytetarëve dhe shoqërisë civile, që Spaçi mund dhe duhet të jetë vendi i dokumentimit dhe i përbashkës me abuzimet makabre të periudhës së Komunizmit, pak është folur deri më sot për mënyrën se si mund të kthehet ai në një muze bashkëkohor.

Përfaqja e kujdesshme dhe realiste ndaj muzealizimit të ish-burgut të Spaçit, është synimi i projektit «Shkëmbejmë Përvojat, Formësojmë të Ardhmen: Dialogjet për Spaçin» që zbatohet aktualisht nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), me mbështetjen e Koalicionit Ndërkombëtar të Vendeve të Ndërgjegjjes.

Në sajë të një metodologjite përfshirëse dhe së bashku me një spektër të gjerë aktorësh u bë i mundur, në kuadër të Punëtorisë II, identifikimi dhe vënia në pah e vlerave kryesore të Spaçit, u hodhën bazat drejt formulimit të një deklaratë vizioni të përbashkët për të ardhmen e tij si dhe u shqyrtuan përfaqset e mundshme për muzealizimin e tij duke u bazuar në shembuj nga vendi e më gjerë. Një nga rezultatet kryesore të Punëtorisë II ishte formulimi i objektivave të qartë dhe operacionale mbi muzealizimin e Spaçit, të cilët do ti prijnë formulimit të plan-veprimit për jetëzimin e prioritetëve të identifikuar (Punëtorja III).

Objektivat e formuluar gjatë Punëtorisë II janë:

1. *Edukimi, interpretimi dhe përfshirja e publikut*

- a. Ngritje e ndërgjegjësimit dhe edukim i komunitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar rreth historisë së vuajtjeve dhe rezistencës së ish të burgosurve në Spaç.
- b. Interpretim i vendit në mënyrë që çdo individ të kuptojë vlerën e Spaçit dhe të japë kontributin për ruajtjen dhe promovimin.
- c. Bashkëpunim në shkallë të gjerë për të arritur përfshirjen dhe integrimin e ish të burgosurve dhe grupeve të përjashtuara.
- d. Inkurajim për aktivizëm dhe përfshirje të

- d. Encourage activism and social engagement from all visitors, especially the young generations, towards the betterment of society.

2. *Buildings and infrastructure*

- a. Reconstruct/conservate existing buildings (focusing interventions on special parts, e.g. the watchtowers, the mine galleries) based on reference materials from the time.
- b. Create possibilities for alternative routes to access and experience the prison.
- c. Continually build and improve upon infrastructure and support structures to facilitate the needs of visitors on site and in Reps.

3. *Legal framework, management and strategic approaches*

- a. Found a museum institution on the highest national level, a National Museum of Memory – Spaç (NMMS).
- b. Establish clear legal regulations regarding the creation, structure and management of NMMS.
- c. Integrate NMMS into international networks and itineraries/sites of remembrance.
- d. NMMS serves as a model in Albania and the region for inclusive practices and debates on the most relevant contemporary issues.
- e. NMMS serves as an engine of economic, cultural and social development for Mirdita.

gjithë vizitorëve, veçanërisht brezat e rinj, drejt përmirësimit të shoqërisë.

2. *Ndërtesat dhe infrastruktura*

- a. Rindërtim/konservim i ndërtesave ekzistuese (duke përqëndruar fillimisht në pjesë të veçanta, p.sh. kullat e vrojtimit, galerite e minierave) duke u bazuar në materiale të kohës.
- b. Krijim i mundësive për rrugë alternative për qasjen dhe përjetimin e ish burgut.
- c. Ndërtim dhe përmirësim i vazhdueshëm i infrastrukturës dhe strukturave ndihmëse për të lehtësuar nevojat e vizitorëve in situ dhe në Reps.

3. *Korniza ligjore, menaxhimi dhe përfaqshet strategjike*

- a. Themelimi i një institucioni muze i nivelit më të lartë kombëtar, një Muze Kombëtar i Kujtesës – Spaç (MKKS)
- b. Vendosja e rregullave ligjore të qarta përsa i përket krijimit, strukturimit dhe menaxhimit të MKKS
- c. Integrimi i MKKS në rrjetet dhe itineraret/vendet ndërkombëtare të kujtesës.
- d. MKKS në rolin e një modeli në Shqipëri dhe në rajon për praktika përfshirëse dhe debate mbi çështje bashkëkohore dhe shumë të diskutuara
- e. MKKS shërben si një motor zhvillimi ekonomik, kulturor dhe shoqëror për Mirditën.



Fig. 1: The workshop group in the conference room | Grupi i punëtorisë në sallën e konferencës

INTRODUCTION

HYRJJE

Background

A number of the political prisoners who were taken to Spaç prison were artists, writers and other intellectuals, many of whom have spoken out about their experience in recent years. This has helped to make Spaç one of the most symbolic sites for the horror of persecution under the Communist regime, as well as perhaps the site that is most present in the collective memory of Albanians. As such, the primary value of Spaç today is as a much-needed place of memory for the crimes of the Communist regime—a physical space to 'locate' and address the traumas of that past, both for the former political prisoners who suffered there and for the rest of the Albanian people. Such sites of memory can represent not only the trauma of that period, but also resistance to and, ultimately, the downfall of the former regime.

Today, there seems to be a growing consensus among institutions, citizens and civil society actors that Spaç could and should serve as a place for documenting and confronting the abuses of human rights that occurred under the Communist regime. In addition, this site will be an important means of teaching Albanians and foreigners about this difficult period of history in a deep, experiential way. This comes at a time when tourism demand for former Communist sites is on the rise, potentially creating a much-needed economic opportunity for the local community, which is suffering from chronic poverty and steady emigration.

Finally, the success of Spaç in dealing with this specific type of heritage would make it possible to form a contemporary approach to revitalizing the sites of persecution in Albania, hoping that after Spaç, the same process could be undertaken for Qafë Bari, Bënça and so on with many more sites of conscience.

Prapavija

Spaçi është një nga vendet emblematike të tmerrit të persekutimit Komunist dhe ndoshta vendi që më së shumti është i pranishëm në kujtesën kolektive të Shqiptarëve. Si i tillë, vlera parësore e tij sot është identifikimi nga të gjithë si vend shumë i nevojshëm i kujtesës së krimeve të regjimit Komunist – një vend fizik, ku jo vetëm ish të përndjekurit politikë por e tërë shoqëria, mishëron e shëron traumat e së kaluarës Komuniste. Të tillë vende të kujtesës mund të përfaqësojnë jo vetëm traumat e kësaj periudhe por gjithashtu rezistencën ndaj regjimit si dhe rënien e tij.

Duket të ekzistojë një lloj konsensusi i përgjithshëm mes institucioneve, qytetarëve dhe shoqërisë civile, që Spaçi mund dhe duhet të jetë vendi i dokumentimit dhe i përballjes me abuzimet makabre ndaj të drejtave themelore të njeriut të kryera gjatë regjimit Komunist. Një vend i të tillë do të kishte dhe një dimension të rëndësishëm edukativ e arsimor që do të mundësonte, për Shqiptarë e të huaj, një përvojë të plotë dhe të prekshme për këtë periudhë të vështirë historike. Ky vizion përputhet gjithashtu me tendencat në rritje të turizmit në/për vendet e Komunizmit, çka do të gjeneronte mundësi jetike zhvillimi ekonomik për bashkësinë lokale që vuan prej kohësh nga varfëria dhe emigracioni.

Së fundmi Spaçi si model i mirë i trajtimit të kësaj trashëgimie specifike do të formësonte një përqasje dhe një përvojë bashkëkohore të revitalizimit të vendeve të persekutimit, duke shpresuar që pas Spaçit t'u vijë rradha dhe Qafë-Barit, dhe Bënçës, e shumë vendeve të tjerë të ndërgjegjes.

The Dialogues for Spaç project

In 2014, Cultural Heritage without Borders (CHwB) began implementation of the project “Sharing Stories, Shaping the Future: Dialogues for Spaç”, with the support of the International Coalition of Sites of Conscience.

This project will organize a series of three workshops, two of which have been held successfully so far:

- Workshop I, held June 12 – 14, 2014 in Mirdita, aimed to deepen our knowledge about Spaç and familiarize all of the participants about the primary issues and understandings surrounding the site.
- Workshop II, held October 30 – November 1, 2014 in Shkodra, was built around values, various case studies and primary objectives, which should guide the creation of a museum at the former prison.
- Workshop III aims to finalize a concrete, quality and appealing action plan, in order to give life to these proposals.

An essential part of this project is the creation of a common space for dialogue among individual and institutional voices. Each has its own history; its own experiences related to Spaç; its own point of view on the meaning and value of this site that symbolizes the repressive Communist system and, therefore, different expectations about its future.

The chart below (next page) outlines the main steps in the project:

Projekti i Dialogjeve për Spaçin

Gjatë vitit 2014, CHwB ka filluar zbatimin e projektit “Shkëmbejmë Përvojat, Formësojmë të Ardhmen: Dialogjet për Spaçin”, me mbështetjen e International Coalition of Sites of Conscience.

Projekti synon organizimin e një serie prej 3 punëtorish, nga të cilat dy janë mbajtur me sukses deri tani:

- Punëtorja I, e mbajtur më datat 12-14 Qershor 2014 në Mirditë, kishte si synim thellimin e njohurive për Spaçin dhe familjarizimin e të gjithë pjesëmarrësve me problematikat dhe kuptimet kryesore të Spaçit.
- Punëtorja II, e mbajtur në datat 30 Tetor – 1 Nëntor 2014 në Shkodër, u ndërtua rreth vlerave, shembujve të ndryshëm dhe objektivat kryesorë që duhet të prijnë kthimin në muze të ish-burgut të Spaçit.
- Punëtorja III, datat e së cilës mbeten ende për tu përcaktuar, synon finalizimin e propozimeve në një plan-veprimi konkret, cilësor dhe ndjellës për ti dhënë jetë propozimeve.

Pjesë thelbësore e këtij projekti është krijimi i një hapësire të përbashkët për dialog mes zërave institucionalë dhe individualë që kanë historitë, përvojat e tyre në lidhje me Spaçin, pikëpamjet e tyre - jo domosdoshmërisht të njëjta - mbi kuptimin dhe vlerat e këtij vendi simbol të sistemit represiv Komunist, e për rrjedhojë, pritshmëri të ndryshme për të ardhmen e tij. Skema e projektit (më poshtë) përmbledh hapat kryesorë të projektit:




Fig. 2: Skema e projektit




Fig. 3: Project scheme

Workshop II objectives

Workshop I was focused on creating/strengthening the group's knowledge about Spaç and understanding of the primary issues surrounding it.

The goal of Workshop II was to mobilize all of the knowledge from Workshop I, information brought to the table by different stakeholders, as well as the experiences and expectations of the participants, in order to:

- Identify and highlight the values of Spaç
- Converge toward a joint vision of Spaç in the future
- Understand the operational context of museums in Albania and abroad
- Define clear and realistic objectives on the road to turning the former prison into a museum

Similar to the previous workshop, the methodology focused around discussion among the participants, punctuated by short presentations, small group working sessions, presentations from the participants themselves and visits to concrete examples.

Following Mirdita, Shkodra was chosen as the host site for the second workshop for two reasons: 1) to be able to visit one of the most recent examples of a place of suffering

Objektivat e punëtorisë II

Punëtorja I ishte e fokusuar në krijimin/forcimin e një bagazhi njohurish për Spaçin dhe njohjen me problematikën e tij kryesore.

Punëtorja II kishte për qëllim venien në lëvizje të gjithë njohuritë të Punëtorisë I, informacioneve të sjella në tryezë nga palët e ndryshme, si dhe përvojat dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve, në shërbim të:

- Identifikimit dhe vënies në pah të vlerave të Spaçit
- Konvergjimit drejt një vizioni të përbashkët për Spaçin në të ardhmen
- Njohjes me kontekstin operacional të muzeve në Shqipëri dhe më gjerë
- Përcaktimit të objektivave të qartë dhe të arritshëm në rrugën drejt muzealizimit të ish-burgut

Metodologjia e përdorur ishte ajo e bashkëbisedimit me grupin e pjesëmarrësve të ritmuar nga prezantime të shkurtra, sesione të punës në grup, prezantime nga vetë pjesëmarrësit si dhe vizita të shëmbujve konkretë.

Së fundmi, pas Mirditës u përzgjedh Shkodra si vend pritës i punëtorisë së radhës, së pari për të pasur mundësinë e vizitës në një nga shembujt e tanishëm të muzealizimit

that has been turned into a museum (the Place of Witness & Memory, Shkodra), and 2) to emphasize that Spaç and the fate of Communist places of persecution more broadly are an issue with national importance.

të një vendi të vuajtjes. Së dyti, në një rrafsh më simbolik, u zgjodh Shkodra për të theksuar se Spaçi dhe më gjerë fati i vendeve të persekutimit komunist, janë një çështje me rëndësi kombëtare.

WORKSHOP AGENDA

AXHENDA E REALIZUAR

DAY 1 | THURSDAY, OCTOBER 30

- 09:00 Departure for Shkodër for participants from Tirana (minibus transport)
- 11:00 Arrival and accommodation in Shkodra for participants from Tirana and Reps
- 12:30 Lunch
- 14:00 Welcome, goals and methodology of Workshop II

Group work & presentations: Joint value analysis of Spaç prison
- 15:30 Coffee break
- 16:00 **Group work & presentations:** Forming a joint vision statement for Spaç
- 20:00 Dinner

DITA 1 | E ENJTE, 30 TETOR

- 09:00 Nisja për në Shkodër për pjesëmarrësit nga Tirana (transporti me minibus)
- 11:00 Mbërritja dhe akomodimi në Shkodër i pjesëmarrësve nga Tirana dhe Repsi
- 12:30 Dreka
- 14:00 Mirësardhja, qëllimi & metodologjia e punëtorisë II

Punë & prezantim në grup: Analiza e përbashkët e vlerave të ish-burgut të Spaçit
- 15:30 Pushim për kafe
- 16:00 **Punë & prezantim në grup:** Formulimi i vizionit të përbashkët për Spaçin
- 20:00 Darka

DAY 2 | FRIDAY, OCTOBER 31

- 09:00 Guided visit to the Place of Witness and Memory – Shkodër
- 10:30 Coffee break
- 11:00 **Group discussion:** Comparing models similar to Spaç, experiences from outside Albania
- 12:30 Lunch
- 14:00 **Group work & presentations:** Objectives analysis
- 15:30 Coffee break
- 16:00 **Group work & presentations:** Finishing the objectives analysis
- 17:30 Evaluation of the workshop by the participants
- 20:00 Dinner

DAY 3 | SATURDAY, NOVEMBER 1

- 09:00 Departure for an organized visit to local cultural heritage sites in and near Shkodër

DITA 2 | E PREMTE, 31 TETOR

- 09:00 Vizitë në Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës – Shkodër
- 10:30 Pushim për kafe
- 11:00 **Diskutim i përbashkët:** Modelet e ngjashme me Spaçin, përvoja nga jashtë
- 12:30 Dreka
- 14:00 **Punë & prezantim në grup:** Analiza e objektivave
- 15:30 Pushim për kafe
- 16:00 **Punë & prezantim në grup:** Përfundimi i analizës së objektivave
- 17:30 Vlerësimi i punëtorisë nga pjesëmarrësit
- 20:00 Darka

DITA 3 | E SHTUNË, 1 NËNTOR

- 09:00 Nisja për vizitën e organizuar në vendet e trashëgimisë kulturore të Shkodrës



LIST OF PARTICIPANTS

LISTA E PJESEMARRESVE

NR.	NAME EMËR	INSTITUTION / ORGANIZATION	INSTITUCIONI / ORGANIZATA
1.	Aleksandër Lala	Orosh Commune, Mayor	Komuna Orosh, Kryetar
2.	Drita Nikolli	Orosh Commune, Archivist/Secretary	Komuna Orosh, Arkiviste/Sekretare
3.	Elton Nikolli	Orosh Commune, Economic Enterprises Administrator	Komuna Orosh, Administrator i Ndërmarrjeve Ekonomike
4.	Gjetë Gjoni	Spaç prison caretaker, local resident	Kujdestar i burgut të Spaçit, Banor vendas
5.	Bilal Kola	Institute for the Integration of the Former Politically Persecuted, Director	Instituti për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, Drejtor
6.	Marsela Karpuzi	Ministry of Urban Development and Tourism; Directorate of Territorial Control, Standards and Anti-Corruption; Sector for Control of Urban and Tourist Zones and Implementation of Priorities; Sector Head	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit; Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Standarteve dhe Antikorrupsionit; Sektori i Kontrollit të Zhvillimit Urban e Zonave Turistike dhe Jetësimit të Prioriteteve; Përgjegjëse
7.	Tea Çuni	Place of Witness and Memory – Shkodër; museological specialist	Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës – Shkodër; specialiste muzeologe
8.	Zenel Drangu	Former political prisoner in Spaç, Head of the Association of Former Politically Persecuted People, Shkodër branch	Ish i burgosur politik në Spaç; Kryetar i Shoqatës së ish të Përndjekurve Politikë, dega Shkodër
9.	Luigi Mila	“Spaç Prison Museum” Association, Head	Shoqata “Muzeumi Burgu i Spaçit”, Kryetar
10.	Vladimir Banushi	“Spaç Prison Museum” Association, Project Assistant	Shoqata “Muzeumi Burgu i Spaçit” Asistent Projekti
11.	Dafne Bajraktari	University of Tirana, Faculty of History & Philology, Journalism Dept., Student	UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dpt i Gazetarisë, Studente
12.	Nedina Dajko	University of Tirana, Faculty of History & Philology, Journalism Dept., Student	UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dpt i Gazetarisë, Studente

13.	Jonathan Eaton	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Program Coordinator	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Koordinator programi
14.	Nedi Petri	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Project Assistant	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Asistent projekti
15.	Mirian Bllaci	Cultural Heritage without Borders (CHwB), Project Manager	Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Menaxher projekti

Fig. 4: Seeing successes and problems at the new museum about communism in Shkodra
Duke parë sukseset dhe problemet e muzeumit të ri për komunizmin në Shkodër



THE WORKING PROCESS PROCESI I PUNES

Value analysis

Spaç prison holds many values for us today. Some of these are taken for granted by all, for example, the fact that Spaç bears witness to the political persecution that occurred under the Communist dictatorship. Other values are linked to the beliefs and viewpoints of each and every person, according to their specific context.

The important thing is that a full analysis of values helps us to create a balance between the urgent needs of Spaç today and the preservation of its values for the future.

With this goal, the participants broke into three groups and identified the following values.

Note:

The categorization of values was made by CHwB in accordance with the opinions and expressions of participants during the workshop. It's important to note that these categories are not mutually exclusive, and they are not ranked according to importance. Also, the same value might fit easily into several categories.

Historical / testimonial values:

- Spaç is one of the most emblematic places of persecution and the violation of human rights during the Communist dictatorship, as well as resistance to it.
- Even today, Spaç entirely retains its original character and appearance as a place of suffering.
- In the collective memory of Albanians, Spaç is the true face of the Albanian Communist regime.

Political / social values:

- Spaç is a place that symbolizes perseverance and struggles for ideals like freedom, pluralism and a democratic society.
- It has the symbolic force to turn into an instrument

Analiza e vlerave

Ish-burgu i Spaçit është bartës i shumë vlerave. Disa prej këtyre vlerave mund të konsiderohen si të mirëqëna nga të gjithë, si për shëmbull fakti që Spaçi është një dëshmi e fortë e përndjekjes për motive politike gjatë diktaturës komuniste. Disa të tjera janë të lidhura me botëkuptimin dhe pikëpamjet e gjithësecilit, me kohën dhe kontekstin ku trajtohen.

E rëndësishme është që një analizë e plotë e vlerave lehtëson drejtpeshimin mes nevojave urgjente të Spaçit sot dhe nga ana tjetër, ruajtjes së vlerave që ai mbart për të ardhmen.

Me këtë synim pjesëmarrësit të ndarë në tri grupe identifikuan vlerat në vazhdim.

Shënim: Kategorizimi i vlerave është bërë nga CHwB në përputhje me mendimet e shprehura nga pjesëmarrësit gjatë punëtorisë. Vlen për tu theksuar se këto kategori as nuk përjashtojnë njëra-tjetrën dhe as nuk janë të renditura sipas rëndësisë. Gjithashtu e njëjta vlerë mund të jetë njëkohësisht pjesë e disa kategorive.

Vlerat historike / dëshmuese:

- Spaçi është një nga vendet emblematike të persekutimit, shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste, por edhe të qëndresës ndaj saj.
- Ende sot Spaçi ruan në tërësinë e tij karakterin origjinal dhe fizionominë e një vendi të vuajtjes.
- Në kujtesën kolektive të Shqiptarëve, Spaçi është fytyra e vërtetë e regjimit komunist në Shqipëri.

Vlerat politiko-shoqërore:

- Spaçi është një vend që simbolizon gjithashtu qëndresën dhe përpjekjet për ideale si liria, pluralizmi dhe shoqëria demokratike.
- Ka forcën simbolike për kthyer në një instrument

for forgiveness, awareness about issues of political persecution and dealing with the country's difficult past.

Cultural values:

- Spaç prison was declared a second-category 'cultural monument' because of its historical and national importance.
- Spaç has been and is a source of inspiration for various artistic works (books, paintings, etc.), often created by former political prisoners themselves.

Local / community values:

- Spaç has become a spiritual symbol of suffering inside and outside the prison itself, during and after the Communist period, for the community of people who were politically persecuted.
- Spaç is also a very important place for various religious communities in Albania, since the sentences of eminent clergy members were carried out there.
- It also bears special meaning for the local people of Orosh Commune.

Rarity / uniqueness values:

- Spaç is one of the only Communist prisons or camps that has survived total destruction.
- Today, Spaç is the only site from the former network of persecution that is officially under the protection of the Albanian state (as a listed 'cultural monument').
- Of all the institutions of repression, Spaç is the one most present in the collective memory.
- Spaç was the scene of one of the few uprisings against the Communist regime: the revolt of May 1973.

Educational values:

- Spaç recounts the history of persecution in Albania in a tangible way.
- As such, it encourages the formal and informal education of the younger generations about the former and current issues surrounding freedom, equality, rights and democracy.

Natural / landscape values:

- Built in an isolated valley of Mirdita, Spaç is characterized by natural surroundings that are still well preserved.
- The scope of the former prison and mine complex, which extends up the face of the mountainside, is an important landscape feature.

faljeje, ndërgjegjësimi ndaj çështjeve të përndjekjes politike dhe ballafaqimi me të shkuarën problematike të vendit.

Vlerat kulturore:

- Ish-Burgu i Spaçit është shpallur Monument Kulture i kategorisë së dytë për rëndësinë e tij historike dhe kombëtare.
- Spaçi ka qënë dhe është burim frymëzimi për vepra të ndryshme artistike (libra, piktura, etj) shpeshherë të krijuara nga vetë ish të burgosurit politikë.

Vlerat lokale / të komunitetit:

- Spaçi është kthyer në një simbol shpirtëror të vuajtjeve brenda dhe jashtë burgut, gjatë dhe pas periudhës së komunizmit për bashkësinë e ish-të përndjekurve politikë.
- Spaçi është gjithashtu dhe një vend shumë i rëndësishëm për bashkësitë e ndryshme fetare në Shqipëri teksa aty kanë vuajtur dënimet e figura të spikatura të klerit.
- Ai mbart dhe kuptim të veçantë për vendasit e Komunës së Oroshit.

Vlerat e rrallësisë / veçantisë:

- Spaçi është një nga të vetmit burgje apo kampe të komunizmit që i ka mbijetuar asgjësimit total.
- Spaçi është sot i vetmi vend i rrjetit të dikurshëm të persekutimit që është zyrtarisht nën mbrojtje të Shtetit Shqiptar (Monument Kulture).
- Spaçi është një nga institucionet represive që është më së shumti i pranishëm në kujtesën kolektive.
- Spaçi ka qënë skena e një prej të paktave kryengritje kundër regjimit komunist, si revolta e Majit 1973.

Vlerat edukative:

- Spaçi rrëfen historinë e përndjekjes në Shqipëri në mënyrë të prekshme.
- Si i tillë, ai inkurajon edukim formal dhe joformal të brezave të rinj, në lidhje me problematikat e shkuara dhe bashkohore të lirisë, barazisë të së drejtave dhe demokracisë.

Vlerat natyrore / peizazhistike:

- I ngritur në një luginë të izoluar në Mirditë, Spaçi karakterizohet gjithashtu nga një zonë rrethuese natyrore ende të ruajtur.
- Shtrirja e kompleksit të ish-burgut dhe minierave në

Economic values:

- For around 20 years, Spaç was left forgotten, but it is slowly becoming a destination for local, national and foreign visitors.
- Consequently, the former prison has potential for generating income from tourists and from using the space for organizing various cultural activities. For example, a museum, generating visitors, would enable economic development in the surrounding zone at the same time, through opportunities to develop accommodation (hotels, guesthouses, etc.) or increased agricultural production.
- The immediate proximity of mineral resources can be, through cooperation, an additional tool for securing the sustainability of Spaç as an institutionalized site of conscience – in service of increasing the welfare of the local community.

Scientific values:

- Spaç is also a case study of theories, techniques and materials used in the construction of industrial centers during the historical period concerned.
- The natural context itself is of interest for investigating the effects of mining and the materials used or extracted on the health of nearby people and the surrounding ecosystem.

faqet e Kodër Spaçit përbën një veçori peisazhistike.

Vlerat ekonomike:

- Për rreth 20 vjet Spaçi është lënë në harresë, por është kthyer në një pikë të vizitueshme për vizitorë lokalë, kombëtarë dhe të huaj.
- Rrjedhimisht ish-burgu ka potencial për gjenerim të ardhurave nga turistët dhe shfrytëzim të hapësirës për organizim të aktiviteteve të ndryshme kulturore. Për shëmbull, kthimi në muze, duke gjeneruar vizitorë, do të mundësonte në të njëjtën kohë dhe zhvillim ekonomik dhe të zonave përreth përmes mundësive si zhvillimi i njërive të akomodimit (bujtina, hotel) apo rritja e prodhimit bujqësor të zonës.
- Afërsia e menjëherëshme e pasurive minerare mund të jetë nëpërmjet bashkëpunimit, një mjet shtesë në sigurimin e qëndrueshmërisë së Spaçit si një vend i institucionalizuar ndërgjegjeje – në shërbim edhe të rritjes së mirëqënies së komunitetit vendas.

Vlerat shkencore:

- Spaçi është dhe një shembull studimi i teorive, teknikave dhe materialeve të ndërtimit të përdorura për qendra industriale në periudhën historike të konsideruar.
- Vetë konteksti natyror i Spaçit paraqet interes për hulumtimin e pasojave të shfrytëzimit të minierave dhe lëndët e përdorura apo të ekstraktuara mbi shëndetin e vetë njerëzve dhe ekosistemit rrethues.



Fig. 5: Moments from the value analysis session | Momente nga sesioni i analizës së vlerave

Visioning

Keywords

The goal of the keyword session was to reflect on the main ideas that should be embodied by a joint vision for Spaç.

Each of the participants proposed three keywords, which formed, by themselves, several larger categories—these constitute the axes of the vision statement (see next page for English keyword chart):

Vizioni


Fjalët kyçe

Sesioni i fjalëve kyçe për vizionin kishte për synim hapjen e reflektimit rreth ideve kryesore që duhet të përmbajë një vizion i përbashkët për Spaçin.

Kështu secili prej pjesëmarrësve propozoi tre fjalë kyçe, të cilat formuan vetvetiu disa kategori të mëdha që mund të përbëjnë boshtet e deklaratës së vizionit:

KUJTESA: Spaçi si vend i Kujtesës është një element konsensual dhe i vlerësuar nga pjesa e mirë e pjesëmarrësve (10 referenca nga 35).


PERSEKUTIMI: Duket gjithashtu që çështja e persekutimit (7 referenca nga 35) është trajta identitare më e fortë për Spaçin në të shkuarën, për të cilën mund të dëshmohet dhe në shprehjen e vizionit të ardhshëm.



POZITIVIMI: Për nga referencat e mbledhura nën këtë kategori (15 referenca nga 35), duket të mbizotërojë ideja e përdorimit të së kaluarës së vështirë si një përvojë mbi të cilën të ndërtohet një e ardhme më e mirë.

ÇËSHTJE KOMBËTARE: Referencat këtu janë disi më të pakta (3 referenca nga 35) por ato përçojnë idenë e trajtimit të Spaçit si një çështje kombëtare apo si faktor unifikues.

MEMORY: Spaç as a site of memory is an element that a good part of the participants agree upon and value (10 references out of 35).



Vision statements

This exercise started with a short discussion about what a vision statement is, how to build a successful one and what elements it should include. After some famous examples of successful vision statements were discussed, the participants were divided into three groups, and each group was tasked with creating two vision statements: one with up to 50 words and one with 12 words or less. By creating these two forms of vision statements, participants delivered, on one hand, a more exhaustive and detailed statement that clearly explains the idea for the future of the former prison and, on the other hand, a more condensed statement that conveys a strong message about its goal.

The vision, seen as an “expression of desire” which shows the way to achieve a long-term goal for Spaç, should be inspirational, positive, encouraging, specific, bringing about something new, ambitious and forward-looking.

Deklaratat e vizionit

Ky ushtrim filloi me një diskutim të shkurtër se çfarë është dhe si mund të ndërtohet një vizion i suksesshëm, çfarë elementesh duhet të përmbajë ai që të jetë i tillë. Pasi u diskutuan disa shembuj të famshëm dhe të suksesshëm pjesëmarrësit u ndanë në tre grupe për të krijuar secili, një deklaratë vizioni me 50 fjalë maksimumi dhe një prej 12 fjalësh. Përpjekja për krijimin e këtyre dy formave shërbeu në dhënien e një formë më shteruese dhe të detajuar që shpjegon qartësisht idenë për të ardhmen e ish burgut, dhe një formë më e kondensuar me idenë e dhënies së një mesazhi të fortë për qëllimin e tij.

Vizioni, i parë si “shprehja e një dëshire” e cila tregon rrugën drejt arritjes së një qëllimi afatgjatë për Spaçin, duhet të ishte frymëzuese, pozitive, inkurajuese, specifike, të sjellë risi, ambicioze, dhe që sheh nga e ardhmja.

Although this exercise was not easy for such a short period of time, the three groups successfully presented their models for the vision statement, which are listed below.

What can be seen from these vision statements is primarily a reflection on the past, through another perspective that sees the past in service of the future. In addition, these vision statements try to determine the future of the former prison as a place that uses documents, events and stories to take you back in time and show you or to create some kind of memorial for what happened there.

GROUP 1

Long statement (max. 50 words)

Return to the place where inhuman pain, lost freedoms and unnamed injustices are felt... where tears and bloodshed overcome the martyrdom of values of a full "library" that was never read... aiming at building a future on human dimensions, whose foundation is forgiveness, memory and education.

Short statement (max. 12 words)

We touch the past while building the future.

GROUP 2

Long statement (max. 50 words)

The Museum of Spaç represents selfless endurance, the spirit of sacrifice and the silent martyrs of freedom.

Short statement (max. 12 words)

Let us solemnly remember so that the tragic past is not repeated.

GROUP 3

Long statement (max. 50 words)

Spaç, this hell of free thought and democracy...

This living witness of the consequences that dictatorships bring...

This example of the need to respect human freedoms, rights and dignity...

...comes to you as a personal, national and international museum, which remembers sufferings, yet also gives hope to future generations, that knowing where we come from, we will understand who we are.

Megjithëse ushtrimi nuk ishte i lehtë për një kohë aq të shkurtër, të tre grupet paraqitën me sukses modelet e tyre të vizionit të cilat janë renditur më poshtë.

Ajo që vihet re nga këto shprehje vizionësh, është kryesisht rishikimi i të shkuarës përmes një këndvështrimi tjetër, që e sheh të shkuarën në shërbim të së ardhmes. Gjithashtu vihet re dhe përpjekje për ta përcaktuar të ardhmen e ish burgut në një vend që përmes dokumentash, ngjarjesh e historish të çon mbrapa në kohë për të treguar, ose tendenca për krijimin e lloj memoriali ose përkujtimore për çka ka ndodhur.

GRUPI 1

50 fjalësh

Kthim në vendin ku ndihet dhimbja çnjerëzore, liritë e munguara, padrejtësitë e paemërta... ku lotët dhe gjaku i derdhur prevalojnë martirizimin e vlerave të një "biblioteke" të mbushur, por kurrë të lexuar... duke synuar ndërtimin e një të ardhmeje mbi dimensionin njerëzor dhe që ka në themel faljen, kujtesën dhe edukimin.

12 fjalësh

Të prekim të shkuarën duke ndërtuar të ardhmen.

GRUPI 2

50 fjalësh

Muzeu i Spaçit përfaqëson qëndresën vetmohuese, shpirtin e sakrificës dhe martirët e heshtur të lirisë.

12 fjalësh

Le të kujtojmë me solemnitet që e shkuara tragjike të mos përsëritet.

GRUPI 3

50 fjalësh

Spaçi, ky ferr i mendimit të lirë dhe demokracisë...

Kjo dëshmi e gjallë e pasojave që sjellin diktaturat...

Ky shembull i nevojës së respektimit të lirive, të së drejtave dhe dinjitetit njerëzor...

...vjen tek ju si një muze personal, kombëtar dhe ndërkombëtar që kujton vuajtjet, por u jep shpresë brezave të ardhshëm që duke ditur nga vijnë, do të kuptojnë se kush janë.

Short statement (max. 12 words)

We cannot understand who we are without knowing where we come from.

During the discussions that followed the presentations of the vision statements, the participants seemed to be in agreement about the fact that the long vision statement of group 3 is the one that best expresses the role and importance of Spaç for the future, as a model place for ideas and dialogue, which will use its collections/exhibitions to inspire people.

Spaç

... This hell of free thought and democracy,
... This living witness of the consequences that dictatorships bring,
... This example of the need to respect human freedoms, rights and dignity,
... Comes to you as a personal, national and international museum, which remembers sufferings, yet also gives hope to future generations, that knowing where we come from, we will understand who we are.

We cannot understand who we are without knowing where we come from.

12 fjalësh

S'mund të kuptojmë kush jemi, pa e ditur nga vijmë.

Gjatë diskutimeve që vijuan pas prezantimeve të deklaratave të vizionit, pjesëmarrësit dukej të ishin dakord mbi faktin se vizioni 50 fjalësh i grupit 3 është ai që më së miri shpreh rolin dhe rëndësinë e Spaçit për të ardhmen, si një hapësirë model për ide dhe dialog dhe që do të përdorë koleksionet/ekspozitat e saj për të frymëzuar njerëzit.

Spaçi

... Ky ferr i mendimit të lirë & demokracisë,
... Kjo dëshmi e gjallë e pasojave që sjellin diktaturat,
... Ky shembull i nevojës së respektimit të lirive, të së drejtave dhe dinjitetit njerëzor,
... Vjen tek ju si një muze personal, kombëtar dhe ndërkombëtar që kujton vuajtjet, por u jep shpresë brezave të ardhshëm që duke ditur nga vijnë, do të kuptojnë se kush janë.

S'mund të kuptojmë kush jemi, pa e ditur nga vijmë.

